



BASHKIA  
LEZHË



BASHKIA  
MIRDITË

# PROGRAMI



## Parlamenti **IV** Rural Shqiptar

# Evropa në Shqipërinë Rurale

*Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së përmes partneriteteve,  
reformës dhe zhvillimit territorial koheziv*

BASHKITË PRITËSE:

**Bashkia e Lezhës dhe Bashkia e Mirditës**

25-27 MARS 2026

ME MBËSHTETJEN FINANCIARE TË:



Ministero degli Affari Esteri  
e della Cooperazione Internazionale



10 AGENZIA ITALIANA  
PER LA COOPERAZIONE  
ALLO SVILUPPO



CIHEAM  
BARI



Food and Agriculture  
Organization of the  
United Nations



Funded by  
the European Union



FARM FORK  
ACADEMY

## SHËNIM:

*Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të projektit EU GoAL - Mbështetje institucionale për Shqipërinë në sektorët e bujqësisë dhe peshkimit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), dhe i zbatuar nga CIHEAM Bari.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatave financuese apo zbatuese.*

## MIRËNJOHJE

*Ky aktivitet organizohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe mbështetet financiarisht nga:*

- *Projekti “Mbështetje institucionale për Shqipërinë në sektorët e bujqësisë dhe peshkimit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian - EU GoAL”, financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), dhe i zbatuar nga CIHEAM Bari;*
- *Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), kontributi i së cilës ofrohet përmes programeve kryesore si Business, Partnerships and Solutions for SDGs (B4SDGs), Digital Agriculture and Rural Transformation in Albania (DART), si dhe Mbështetje për përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe zhvillimit rural lokal në kontekstin e integritimit në BE.*
- *Projekti rajonal “Akademia nga Ferma në Tryezë për Ballkanin Perëndimor të Gjelbër - E ardhmja jonë e përbashkët evropiane”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga konsorciumi i Rrjeteve Kombëtare për Zhvillimin Rural në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroaci, së bashku me platformën e tyre rajonale të bashkëpunimit, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin Rural.*

# Parlamenti IV Rural Shqiptar

## Evropa në Shqipërinë Rurale:

### *Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së përmes partneriteteve, reformës dhe zhvillimit territorial koheziv*

Parlamenti Rural Shqiptar është një platformë e qëndrueshme kombëtare e advokacisë dhe dialogut, ndërtimit të kapaciteteve dhe rrjetëzimit në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. I frymëzuar nga Parlamenti Rural Evropian dhe pjesë e lëvizjes pan-evropiane për zhvillimin e qëndrueshëm rural, Parlamenti Rural Shqiptar amplifikon zërat e komuniteteve rurale, artikulon prioritetet dhe interesat e tyre si dhe promovon veprimin kolektiv në partneritet me shoqërinë civile, autoritetet vendore dhe institucionet kombëtare.

Që prej fillimit, tre edicionet e mëparshme të Parlamentit Rural Shqiptar (më 2017, 2021 dhe 2023) kanë nxitur rritjen e besimit, angazhimit dhe përkatësisë midis aktorëve të interesit në zhvillimin rural duke forcuar rolin e vet si platformë unifikuese e interesave dhe prioritetëve rurale në të gjithë Shqipërinë. Platforma e Parlamentit Rural lidh komunitetet rurale me proceset e qeverisjes, duke siguruar që përvojat, nevojat dhe prioritetet e tyre influencojnë në mënyrë domethënëse veprimet dhe politikat publike për zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke u mbështetur dhe ndërtuar më tej në këtë përvojë të edicioneve të mëparshme, Parlamenti IV Rural Shqiptar përforcon dialogun ndërmjet komuniteteve rurale dhe vendimmarrësve, gjeneron rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për politikat dhe promovon zhvillimin rural gjithëpërfshirës, koheziv dhe të qëndrueshëm. Në një moment kaq të rëndësishëm në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, Parlamenti Rural pozicionon aktorët ruralë si kontribues aktivë në reformat që lidhen me bujqësinë, zhvillimin rural dhe kohezionin territorial.

E mërkurë, 25 mars 2026

## EVENTI LOKAL ME AKTORËT TERRITORIAL NË QARKUN E LEZHËS DHE SHKODRËS

### Sinergji territoriale për zhvillim lokal të udhëhequr nga komuniteti (qasja LEADER)

**Vendi:** Bashkia Mirditë, salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

**Ora:** 15:00 - 18:30

*Ky aktivitet bën bashkë aktorët vendorë dhe rajonalë të Qarkut Lezhë dhe Shkodër, veçanërisht nga dy bashkitë pritëse të Parlamentit IV Rural Shqiptar, Lezhë dhe Mirditë, për të eksploruar se si nismat, aktorët dhe praktikat e mira ekzistuese mund të sinergjizohen në një qasje të përbashkët territoriale, në përputhje me metodologjinë e BE-së LEADER / Zhvillimi Lokal i Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD).*

*Duke u bazuar në identitetin e fortë lokal, praktikat e qëndrueshme dhe angazhimin e komunitetit në zonë, sesioni synon të kalojë nga iniciativat e fragmentuara në një vizion të përbashkët territorial, duke hedhur themelet për formimin e Grupeve Vendorë të Veprimit.*

**15:00 – 15:30**

#### **Hapja zyrtare: Parlamenti IV Rural Shqiptar**

**Mirëseardhje dhe fjalët përshëndetëse:**

- Albert Mëlyshi, Kryetar i Bashkisë Mirditë
- Sotiraq Hroni, Kryetar i Bordit, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural
- Agron Ivani, Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë (tbc)
- Fatjon Zefi, Nënkrjetar, Bashkia Lezhë
- Eranda Selmanaj, Drejtore e Programimit dhe Monitorimit të IPARD

**15:30 - 16:30**

#### **Hyrje në tematikë dhe konteksti vendor**

***Pse qasja LEADER /Zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti për këtë territor? Evelina Azizaj, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural***

***LEADER në praktikë: përvoja ndërkombëtare dhe reflektime nga Shqipëria Reflektime nga ekspertë me përvojë në zbatimin e qasjes LEADER dhe në funksionimin e GVV:***

- Kristiina Tammets, Eksperte Ndërkombëtare, FAO
- Kim Smedslund, Leader group EMO, Finland
- Roland Bardhi, Ekspert i lartë për zhvillimin rural
- Linda Maci, Drejtore e Programimit të Zhvillimit, Këshilli i Qarkut Lezhë

*Ky sesion synon të vendosë kuadrin e diskutimit territorial duke lidhur potencialet e territorit me përvojat praktike të qasjes LEADER dhe mundësitë për bashkëpunim vendor në kontekstin e zhvillimit rural dhe integritimit evropian. Përmes perspektivave ndërkombëtare, reflektimeve nga përvoja shqiptare dhe njohurive mbi dinamikën e zhvillimit territorial të zonës, sesioni do të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë se çfarë përfaqëson në praktikë qasja LEADER, si krijohen dhe funksionojnë GVV-të, cilat janë kushtet që e bëjnë një territor të përshtatshëm për një qasje të përbashkët zhvillimi, si dhe çfarë mësimesh mund të nxirren nga përvoja ndërkombëtare dhe nga iniciativat e hershme të frymëzuara nga LEADER në Shqipëri.*

**16:30 – 17:00**

## **Hartëzimi i potencialit lokal dhe nismave ekzistuese: Çfarë po ndodh tashmë në terren?**

### ***Ndërhyrje të shkurtra dinamike që nxjerrin në pah:***

- Bujqësinë e qëndrueshme dhe sistemet ushqimore lokale.
- Turizmin rural, trashëgiminë kulturore dhe asetet natyrore.
- Nismat e udhëhequra nga të rinjtë dhe gratë.
- Shërbimet lokale dhe inovacionin social.
- Praktikat e tjera territoriale.

*Përgjatë prezantimeve, do të lehtësohet edhe hartëzimi vizual i nismave, potencialeve, aktorëve për të evidentuar ekosistemin e pasur lokal, por shpesh të palidhur të tyre.*

**17:00 – 17:45**

## **Sinergjizimi i aktorëve të interesit për të kaluar nga nisma në partneritete: Çfarë mund të ndërtojmë së bashku?**

### ***Dialog shumë-aktorial i lehtësuar mbi:***

- Mundësitë zhvillimore
- Sfidat e bashkëpunimit
- Prioritet tematike për GVV-të e ardhme

Lehtësues: R.Gradeci, R.Bardhi, E.Azizaj

**17:45 - 18:30**

## **Hapat drejt krijimit të GVV-ve në territoret pritëse**

- Identifikimi i aktorëve të interesit
- Prioritetet tematike të përcaktuara për një strategji të ardhshme të GVV-ve (bujqësi e qëndrueshme, sipërmarrje rurale, turizëm, shërbime, inovacion, përfshirje sociale);
- Diskutimi i hapave të mëtejshëm praktikë, duke përfshirë:
  - ▶ formimin e grupeve të vogla të punës/ koordinuese
  - ▶ nevojat për asistencë teknike, ndërtim të kapaciteteve, lehtësim etj.)
  - ▶ diskutimi i hapave pasues, nevojat për mbështetje dhe mekanizmat koordinues.

*Fjalë përmbyllëse nga ANRD dhe bashkitë pritëse, duke riafirmuar angazhimin për zhvillimin e udhëhequr nga niveli lokal dhe ndjekur hapat e mëtejshëm.*

**18:30 – 19:30**

## **Koktejl**

E enjte, 26 mars 2026

# SHQIPËRIA RURALE NË RRUGËN DREJT EVROPËS: ÇFARË DO TË THOTË PËR KOMUNITETET DHE TERRITORET

Vendi: Pallati i Kulturës “Ded Ndue Lazri”, Lezhë

**09:00 – 10:30**

## **Mbërritja, Regjistrimi i pjesëmarrësve**

*Kafe e mirëseardhjes dhe rrjetëzim informal*

**10:30 – 11:15**

## **Hapja zyrtare e Parlamentit të IV Rural Shqiptar**

### ***Fjalët e mirëseardhjes nga organizatorët dhe bashkitë pritëse***

- Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural
- Pjerin Ndreu, Kryetar i Bashkisë Lezhë
- Albert Mëlyshi, Kryetar i Bashkisë Mirditë
- Ardit Frroku, Anëtar i Bordit, Qendra e Rinisë Rurale

### ***Kontributet kryesore institucionale:***

- Fatmir Guri, Zv. Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Fatbardh Sallaku, Rektori, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Andrea Ferrero, Drejtues i Seksionit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik dhe Social, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
- Franco Turri, Drejtues i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
- Raimund Jehle, përfaqësues i FAO-s në Shqipëri (videomesazh)

### ***Kontribute nga të ftuarit***

- Petar Gjorgievski, President, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin Rural
- Kim Smedslund, Ekipi drejtues, Parlamenti Rural Evropian

**11:15 – 13:00**

## **Sesioni Plenar “Shqipëria rurale në rrugën drejt Evropës: Çfarë do të thotë kjo për komunitetet dhe territoret”**

Moderator: Renaldo Salianji

*Paneli përcakton vizionin e përgjithshëm dhe kontekstin politik të Parlamentit Rural Shqiptar duke eksploruar se çfarë do të thotë konkretisht rrugëtimi i Shqipërisë drejt integritimit evropian për komunitetet rurale, bashkitë dhe territoret.*

*Diskutimet do të fokusohen te situata aktuale e Shqipërisë rurale sot në lidhje me reformat kombëtare dhe kërkesat e BE-së, dhe se në ç’mënyrë politikat, standardet dhe programet e financimit evropian përkthehen në mundësi, sfida dhe përgjegjësi në nivel lokal. Paneli synon të ndërtojë një kuptim të përbashkët të prioritetëve, të qartësojë rolet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të formulojë pyetjet kryesore që do të eksplorohehen më tej përmes dialogut pjesëmarrës gjatë pjesës së dytë të kësaj dite të Parlamentit IV Rural Shqiptar.*

### **Reflektime në panel nga perspektiva të ndryshme:**

- Fatmir Guri, Zv. Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Erinda Lika, Zv. Rektore për Shkencën dhe Projektet, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Alberto Sartori, Koordinator Ndërkombëtar i Projekteve, CIHEAM Bari
- Agron Haxhimali, Drejtor i Institutit për Bashkitë e Shqipërisë
- Hafuz Domi, Drejtor, Adad malore
- Alba Tema, Koordinatore Kombëtare, Qendra e Rinisë Rurale
- Kristiina Tammets, Eksperte Ndërkombëtare, FAO

### **Diskutim i hapur me pjesëmarrësit**

**13:00 – 14:00**

## **Drekë & rrjetëzim**

**14:00 – 14:30**

**Edicioni i dytë i çmimit “Pier Paolo Ambrosi” për Leadership në Zhvillimin Rural** – një nismë që i kushtohet nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Pier Paolo Ambrosio që udhëhoqi zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri.

*Çmimi njeh dhe vlerëson aktorët vendorë, të cilët tregojnë leadership dhe kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale në të gjithë Shqipërinë. Çmimi promovohet nga ANRD dhe VIS Albania çdo dy-tre vjet në Parlamentin Rural Shqiptar.*

**Vendi:** Pallati i Kulturës “Ded Ndue Lazri”

**14:30 – 17:00**

**PUNËTORI TEMATIKE PARALELE  
(Raundi I dhe II)**

**NGA ZËRAT RURALE TEK ZGJIDHJET E PËRBASHKËTA:  
PJESËMARRJA, DIALOGU DHE BASHKËKRIJIMI**

*Pjesa e dytë e ditës fokusohet në dialogun aktiv dhe punën tematike, duke vendosur zërat ruralë në qendër të Parlamentit rural. Përmes punëtorive tematike paralele, pjesëmarrësit identifikojnë sfida, ndajnë përvoja nga terreni dhe bashkëkrijnë zgjidhje e rekomandime konkrete për zhvillim rural gjithëpërfshirës dhe në përputhje me BE-në. Këto kontribute do të përbëjnë bazën e Deklaratës së Përbashkët të Parlamentit të IV Rural Shqiptar.*

**14:30 – 17:00**

**ASAMBLEJA E DYTË KOMBËTARE E TË RINJVE NGA ZONAT  
RURALE**

*Të rinjtë do të mblidhen në një sesion të dedikuar për shkëmbim, mësim dhe bashkëkrijim. Përmes dialogut të strukturuar dhe diskutimeve të lehtësuara nga vetë të rinjtë, do të identifikohen sfidat dhe prioritetet kryesore të të rinjve në zonat rurale, si dhe do të formulohen mesazhe dhe propozime konkrete. Këto do të prezantohen në seancën plenare dhe do të përfshihen në Deklaratën e Përbashkët.*

## Punëtori Tematike Paralele BISEDAT RURALE | Raundi 1

**14:30 – 15:30**

Çdo punëtori tematike mbështetet nga një lehtësues, ekspert dhe raportues përgjegjës për dokumentimin e mesazheve kryesore.

Pjesëmarrësit zgjedhin një fushë tematike dhe angazhohen në punë të lehtësuara në grup duke u përqendruar në:

- identifikimin e sfidave kryesore nga terreni;
- ndarjen e përvojave dhe praktikave;
- sqarimin e çështjeve prioritare të politikave.

**14:30  
15:30**

### 1. Zhvillimi gjithëpërfshirës rural dhe qasja LEADER

Vendi: Biblioteka, hyrja kryesore, kati I  
Lehtësues: Evelina Azizaj  
Folës kryesor: Kristiina Tammets, FAO

### 2. Bujqësia e qëndrueshme dhe tranzicioni i gjelbër

Vendi: Biblioteka, hyrja kryesore, kati I  
Lehtësues: Anila Boshnjaku, ANRD  
Folës kryesor: Sara Businaro, FAO

### 3. Fuqizimi i grave në zonat rurale

Vendi: Biblioteka, hyrja kryesore, kati I  
Lehtësues: Tatjana Dishnica, WSA  
Folës kryesor: Eralda Çani, UN Women

## Asambleja e Dytë Kombëtare e të Rinjve nga Zonat Rurale Laboratori i Aftësive

**14:30 – 15:30**

Laboratorët lehtësohen nga OSHC-të partnere dhe organizatat rinore për të forcuar aftësitë, vetëbesimin dhe mirëkuptimin e përbashkët midis të rinjve pjesëmarrës, ndërkohë që diskutimet mbështeten në përvoja të jetës reale nga territore të ndryshme.

**Vendi:** Pallati i Kulturës, Kati II & III

**Laboratori i Aftësive 1:** Agri-sipërmarrja: Nga ideja drejt ndërmarrjeve të qëndrueshme rurale  
Organizata pritëse: Professionistët e rinj për zhvillimin bujqësor (YPARD)  
Lehtësues: Bledar Meta

**Laboratori i Aftësive 2:** Inovacioni dhe aftësitë e buta (soft skills)

Organizata pritëse: Rrjeti i Profesionistëve të Rinj (YPN)  
Lehtësues: Rifat Demalija

**Laboratori i Aftësive 3:** Nga vetëbesimi në

veprim: Fuqizimi i vajzave dhe grave të reja për lidhshmëri dhe aktivizim në komunitetet rurale  
Organizata pritëse: Opportunity Balance and Overcoming (OB&O)  
Lehtësues: Arbëroreta Leti

**15:30  
-16:00**

### Pushim kafeje

### 7. Nga tradita mijëvjeçare në perspektivë evropiane - Trashumanca - krenari e kulturës jomateriale shqiptare

Vendi: Biblioteka  
Lehtësues: Majlinda Lacey,  
Vlerat Baritore - Pasuri  
Kombëtare  
Folës kryesor: Petrit Dobi,  
RASP

### 6. Bujqësia familjare në kuadër të Dekadës së OKB-së.

Vendi: Biblioteka,  
Salla e Gjuhëve  
të huaja, kati III  
Lehtësues &  
Folës kryesor:  
Valbona Ylli, FAO

### 5. Ekonomia rurale e qëndrueshme dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës

Vendi: Biblioteka,  
Salla "Ndoc Gjetja",  
kati III  
Lehtësues: Hafuz  
Domi, Adad malore  
Folës kryesor:  
Klodian Rama, GIZ

### 4. Njohuritë, inovacioni dhe dixhitalizimi

Vendi: Biblioteka,  
Salla "Gjergj Fishta",  
kati III  
Lehtësues: Arsita  
Mati, FAO  
Folës kryesor:  
Francelino  
Rodrigues, FAO

<b>BISEDAT RURALE   Raundi 2</b>		<b>Asambleja e Dytë Kombëtare e të Rinjve nga Zonat Rurale</b>	
<b>16:00 – 17:00</b>			
<b>16:00 – 17:00</b>	<p><b>1. Zhvillimi gjithëpërfshirës rural dhe qasja LEADER (forcimi institucional dhe procesi i akreditimit)</b></p> <p>Lehtësues: Evelina Azizaj Folës kryesor: Kristiina Tammets, FAO</p>	<p><b>2. Bujqësia e qëndrueshme dhe tranzicioni i gjelbër (Shkolla fushore e fermerëve zbatuar nga FAO në zinxhirin e vlerës së perimeve; Sisteme të qëndrueshme ushqimore bazuar në sektorin e qumështit dhe bimët mjekësore dhe aromatike, organizuar nga Akademia nga Ferma në Tryezë)</b></p> <p>Lehtësues: Anila Boshnjaku, Akademia FZF Folës kryesor: Sara Businaro, FAO</p>	<p><b>3. Fuqizimi i grave në zonat rurale</b></p> <p>Lehtësues: Tatjana Dishnica, WSA Folës kryesor: Eralda Çani, UN Women</p>
<b>17:00 – 19:00</b>	<p><b>4. Njohuritë, inovacioni dhe dixhitalizimi (sesion konsultimi rreth portalit të fermerit)</b></p> <p>Lehtësues: Arsita Mati, FAO Folës kryesor: Francelino Rodrigues, FAO</p>	<p><b>5. Ekonomia rurale e qëndrueshme dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës</b></p> <p>Lehtësues: Hafuz Domi, Adad malore Folës kryesor: Klodian Rama, GIZ</p>	<p><b>6. Bujqësia familjare në kuadër të Dekadës së OKB-së. (Sesion konsultimi mbi Planin Kombëtar të Veprimit)</b></p> <p>Lehtësues &amp; Folës kryesor: Valbona Ylli, FAO</p>
<b>17:00 – 19:00</b>	<p><b>7. Nga tradita mijëvjeçare në perspektivë evropiane – Trashumanca – krenari e kulturës jomateriale shqiptare</b></p> <p>Lehtësues: Majlinda Lacej, Vlerat Baritore - Pasuri Kombëtare Folës kryesor: Petrit Dobi, RASP</p>		
<b>19:30 – 21:00</b>	<p>Kohë e lirë dhe rrjetëzim joformal</p>		
	<p>Darkë e përbashkët në restorantin e Hotelit LISS</p>		

E premte, 27 mars 2026

## NGA ZGJIDHJET E PËRBASHKËTA TEK ANGAZHIMI: DIALOGU I POLITIKAVE DHE RRUGA PËRPARA

Vendi: Pallati i Kulturës “Ded Ndue Lazri”, Lezhë

Dita e tretë është dita e sintetizës së rezultateve të procesit pjesëmarrës dhe përkthimit të tyre në mesazhe të qarta politike, angazhime dhe hapa të mëtejshëm. Fokusi do të jetë në prezantimet e mesazheve kryesore dhe prioriteteve që do të ushqejnë Deklaratën e Përbashkët të Parlamentit të IV Rural Shqiptar. Përveç kësaj, diskutohet se si rekomandimet e saj mund të informojnë politikën, programet dhe reformat që lidhen me bujqësinë, zhvillimin rural dhe kohezionin territorial.

**09:00 –  
09:30**

### Mirëseardhje dhe regjistrimi i pjesëmarrësve

**09:30 – 11:30**

### Seancë plenare: Mesazhet kryesore nga Parlamenti IV Rural Shqiptar

Moderator: Renaldo Salianji

#### Rezultatet e shtatë bisedave rurale tematike të prezantuara në perspektivën e raportuesve.

- Zhvillimi gjithëpërfshirës rural dhe qasja LEADER
- Bujqësia e qëndrueshme dhe tranzicioni i gjelbër
- Fuqizimi i grave në zonat rurale
- Njohuritë, inovacioni dhe dixhitalizimi
- Ekonomia rurale e qëndrueshme dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës
- Bujqësia familjare në kuadër të Dekadës së OKB-së
- Nga tradita mijëvjeçare në perspektivë evropiane – Trashumanca – krenari e kulturës jomateriale shqiptare
- Perspektivat dhe propozimet nga Asambleja e të Rinjve nga zonat rurale.

#### Dialog i moderuar me përfaqësuesit institucionalë:

- Arian Jaupllari, Zv. Ministër i Bujqësisë së Zhvillimit Rural dhe Bujqësor
- Përfaqësues nga Komisioni Parlamentar i Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural (tbc)
- Përfaqësues nga bashkitë pritëse
- Sara Bodo, Drejtore, Agjencia Kombëtare e Rinisë (tbc)
- Almira Xhembulla, Nisma “Bijat”

**11:30 – 12:30**

### Ndarja e Çmimeve të Akademisë “Nga Ferma në Tryezë”

Për të njohur nismat dhe kontributet që promovojnë bujqësinë e qëndrueshme, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

**12:30 – 13:00**

### Mbyllja zyrtare e Parlamentit të IV Rural Shqiptar

Hapat e mëtejshëm: Publikimi dhe ndarja e Deklaratës së Përbashkët dhe monitorimi i rekomandimeve

#### Ndërlidhja me procesin e Parlamentit Rural Ballkanik.

- Eranda Selmanaj, Drejtore e Programimit dhe Monitorimit të IPARD (tbc)
- Evelina Azizaj, Koordinatorë Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

**13:00 – 14:00**

### Dreka dhe largimi i pjesëmarrësve



BASHKIA  
LEZHË



BASHKIA  
MIRDITË

## Parlamenti **IV** Rural Shqiptar **Evropa** në **Shqipërinë Rurale**

*Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së përmes partneriteteve,  
reformës dhe zhvillimit territorial koheziv*

25-27 MARS 2026

ME MBËSHTETJEN FINANCIARE TË:



Ministero degli Affari Esteri  
e della Cooperazione Internazionale



Food and Agriculture  
Organization of the  
United Nations



Funded by  
the European Union



FARM & FORK  
ACADEMY